

**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"NEW BEAUTY CLINIC" SHPK.**

Sot, në Tiranë, më **16.04.2024**, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "NEW BEAUTY CLINIC" SHPK.

Unë ortaku i vetëm Maria Letizia Laporta, e bija e Francesco, e datëlindjes 28.09.1961, lindur në Itali dhe banuese në Vlorë në adresën: Rruga Murat Terbaci Nr.105,Kati 4, Ap 15, Vlorë , e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal G15928339T , madhore , me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

**THEMELIMI**

**Neni 1**

Themelohet Shoqëria tregtare "New Beauty Clinic" SHPK, e cila do ti nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

**SELIA E SHOQËRISË**

**Neni 2**

Selia e shoqërisë tregtare "New Beauty Clinic" SHPK do të jetë në adresën: – Bulevardi Gjergj Fishta, Kompleksi Delijorgji, Godina Nr.1, Kati 0(zero), Njesia nr.21, Tiranë Kodi Postar 1001, Zona Kadastrale 8220, e-mail: [letizia.laporta@yahoo.it](mailto:letizia.laporta@yahoo.it), Telefon : +355697098160.

**Neni 3**

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

**Neni 4**

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt "Klinike Estetike dhe kirurgji estetike, shërbim profesional në fushën e estetikës, keshillim dhe ofrim ndërmjetesimi për ndërhyrje të kirurgjise estetike, trajtime të ndryshme të bukurisë, trajtime me lazer e aparatura të tjera të lidhura me estetikën, dermapen, mikrodermoabrazion, jawline contouring, filler për rrudhat, PRP për fytyrën dhe per floket, rathet e syve, white peeling, gummy smile, microneedling, radiofrekuenca, trajtim celuliti, lipolizë etj,".

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë të gjitha aktivitetet e tjera të cilat janë të lejuara sipas kërkesave të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

MARIA LETIZIA LAPORTA



#### **Neni 5**

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

#### **KAPITALI I SHOQËRISË**

##### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 lek (njëmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

##### **Neni 7**

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

#### **DREJTIMI I SHOQËRISË**

##### **Neni 8**

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "New Beauty Clinic" SHPK do drejtohet nga Administratorja e saj Znj. Maria Letizia Laporta për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emërojë një administrator tjetër, nëse e gjykon të nevojshme.

##### **Neni 9**

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë.

##### **Neni 10**

Shoqëria tregtare "New Beauty Clinic" SHPK do ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

##### **Neni 11**

Shoqëria tregtare "New Beauty Clinic" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkruar si më poshtë.

**THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE**

**"New Beauty Clinic" SHPK**

**ORTAKU I VETËM**

**Maria Letizia Laporta**

